



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

Of Nr. / Br 150 / 22

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data / Datum 30.06.2022

VUSHTRIA - VUČITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 1, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, lidhur me nenin 20.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 40, paragrafi 2, shkronja (b) dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022**, merr këtë:

**VENDIM**


**PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2023-2025**

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 e Komunës së Vushtrisë, konform Qarkores Buxhetore 2023/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2023-2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 e Komunës së Vushtrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 1, shkronja (d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në lidhje me nenin 9, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022**, merr këtë:

## VENDIM PËR PËRKUFIZIMIN DHE EMËRTIMIN E LAGJEVE URBANE

1. Me këtë vendim bëhet përkufizimi dhe emërtimi i lagjeve urbane të qytetit të Vushtrrisë si në vijim:

- 1.1. "Lagjja Qendra";
- 1.2. "Lagjja Kalaja";
- 1.3. "Lagjja Ura e Vjetër e Gurit";
- 1.4. "Lagjja Vicians";
- 1.5. "Lagjja Silnica";
- 1.6. "Lagjja Dardania", dhe
- 1.7. "Lagjja liria".

2. \*Lagjja Qendra\* kufizohet me rrugët: "Faruk Beqiri", "Enver Musa", "Zenullah Begu", segmenti i rrugës "Vesli Klark", "Hasan Prishtina" dhe sheshin "Adem Jashari", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: "Shefki Dallku", "Hys Popova", "Burim Muli", "Arsim Muzaqi", "Sulejman Vokshi", "7 Shtatori", "Muharrem Berisha", "Ahmet Selaci", "Jakup Badivuku", "Galip Badivuku", "Shemsi Istrefi", "Rexhep Tërllobuqi", "Aziz Zhilivoda", "Rrahmon Selaci", "Isa Boletini", "Faruk Sunguri", "Bislim Bajgora" dhe rruga "Basri Beqiri".

3. \*Lagjja Kalaja\* kufizohet me rrugët: "Xhavit Mulaku", "Dëshmorët e Kombit", sheshin "Adem Jashari", rruga "Hasan Prishtina", "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", "Ana Lin" dhe "Rrustem Hyseni Historiani", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: "Ekrem Mulaku", "Murat Rashica", "Gjon Buzuku", "Bedri e Nebih Uka", "Burhan Badivuku", "Bedri Bajgora", "Hamdi Ferati", "Ukshin Kovaçica", "Ismajl Parduzi", "Shahin Krasniqi", "Rexhep Musa", "Kruja", "Ali Pashë Tepelena", "Ridvan Qazimi", "Marin Berleti", "Pandeli Sotiri", "Udha e Shkronjave", "Hoxhë Kadri Prishtina", "Shem Nallbani", "Gëzim Rama", "Xhevat Jusufi", "Sali Zeka", "Ismajl Qemajli", "Halit Çuka", "Zeqir Kamerolli", "Ramadan Fazliu", "18 Prilli", "Ferat Novolani", "Luan Haradinaj", "Arsim Rustolli", "Haxhi Zeka", "Ali Buqinca", "Çameria", "Enver Rustolli", "17 Qershori", "Jeronim De Rada", "Nazmi Ispahiu", "Qamil Zeqiri", "Shefqet e Shefki Popova", "Hakif Zejnullahu", "Avni Rustemi",

“Jakup Ceraja”, “Aziz Mehmeti”, “Mursel Bllata”, “Hajzer Jashari”, “Edmond Hoxha”, “Shemsi Ahmeti”, “Bahri Ferizi”, “Naser Hajrizi” dhe rruga “2 Korriku”.

**4. \*Lagjja Ura e Vjetër e Gurit\*** kufizohet me rrugët: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, “Vesli Klark”, segmentin e rrugës “Kadri Zeka”, “Nazmi Aliu”, “Viciania”, “Adnan Shyti”, “Hamdi Gashi”, “Rasim Pasoma” dhe segmentin e rrugës “Mbretëresha Teutë”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Blerim Zuqaku”, “Avni Saraçi”, “Bedri Pejani”, “Xhevat Uka”, “Ferit Mulaku”, “Bahtir Perçuku”, “Mensur Gërguri”, “Rushit Stroci”, “Martirët Grabanica”, “Hamdi Gashi”, “Qamil Haziri”, “Sahit Avdulli”, “Hazir Kolla”, “Lulzim Jashari”, “Shaban Tahiri”, “Durrësi”, “Ramadan Kastrati”, “Hasan Tiku Shabani”, “Mustafë Januzi”, “Mehmet Bivolaku”, “Paria e Drenicës”, “Vehbi Hetemi”, “Hazir Gjaka”, “Ismet Haliti”, “Agim Islami”, “Sefer Duboci”, “Asllan Xhemajli” dhe “Vëllezërit Tahiri”.

**5. \*Lagjja Viciania\*** kufizohet me rrugët: “Tahir Sinani”, “Çanakkala”, “Mehdi Zabeli”, segmentin e rrugës “Lumni Surdulli” dhe “Niman Ferizi”, rrugën “Faruk Beqiri” dhe “Xhavit Mulaku”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Indrit Cara”, “Daut Imeri”, “Martirët e Lirisë”, “Dëshmorët e Kombit”, “Shaban Polluzha”, “Ajet Gërguri”, “Shkolla e Parë Shqipe”, “Kongresi i Manastirit”, “Ferat Muja”, “Sadri Kapiti”, “Selmon Kostanica”, “Qemajl Shaqiri”, “Dituria”, “Avni Klinaku”, “Qerim Qerimi”, “Ahmet Uka”, “Balli Kombëtar”, “Agim Zeqiri”, “Bajram Latifi”, “Eset Ibrahim”, “Shaban Krasniqi”, “Hajriz Musa”, “Liman Bajram Hasani”, “Helge Onsrud”, “Toplica”, segmenti i rrugës “Lumni Surdulli”, rruga “Ejup Kasumi”, “Kadri Dushi”, segmenti i rrugës “Vëllezërit Melenica”, rruga “Ibish Dervishi”, “Jeton Tërrstena”, “Enver Tahiri”, “Shaban e Xhevat Musa”, “Sherif Dibrani”, “Gani Muli”, “Musa Hajdini”, “Ekrem Isufi”, “Selim Bislimi”, “Sherif Kolla”, “Rafet e Burim Rrahmani”, “Isuf Mehana”, “Halit Salihu”, “Hamdi Hajrizi”, “Hamdi Krasniqi”, “Jashar Jashari”, “Burim Hoxha”, “Mehdi Haziri”, “Rexhep Podvorica”, “Abit Kolla”, “Mehdi Musliu”, “Musë Hajrizi”, “Xhemajl Mehmeti”, “Dardania”, “Mehmet Akifi”.

**6. \*Lagjja Silnica\*** kufizohet me rrugët: “Enver Musa”, segmentin e rrugës “Lumni Surdulli”, “Zenullah Begu”, “Kadri Zeka”, “Hamit Hyseni” dhe “Niman Ferizi” “Lidhja e Lezhës”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Sejdi Beqiri”, “Rifat Galica”, “Mursel Istrefi”, “Mehmet Konjuhi”, “Koshtova”, “Mujë Ulqinaku”, “Mustafë Shyti”, “Halit Mikullovc”, “Shaban Mlinaku”, “Fazli Shabani”, segmenti i rrugës “Lidhja e Lezhës”, rruga “22 Maji”, “Bajram Miftari”, “Mic Sokoli”, “Bajram Curri”, “Zymer Haliti”, “Rrahim Sylja”, “Zymer Haziri”, “Adem Ademi”, “Fehmi Tahir Istrefi”, “Bekim Zenuni”, “Mursel Hyseni”, segmenti i rrugës “Isak Halili”, rruga “Hamit Zuqaku”, “Mehmet Xhema”, “Isë Mehmeti”.

**7. \*Lagjja Dardania\*** kufizohet me rrugët: “Tahir Sinani”, “Çanakkala”, “Rrustem Hyseni Historiani”, segmentin e rrugës “Ukshin Hoti”, rrugën “31 Maji”, segmentin e rrugës “Mehmet Kasumi”, rrugën “Vëllezërit Feka”, “Grevja e Minatorëve” dhe segmentin e rrugës “Bahri Kuqi”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Patrioti”, “Halit Konjuhi”, “Zëri i Kosovës”, “Qazim Ademi”, “Hoxhë Brezhnica”, “Njazi Badivuku”, “Miftar Shaqiri”, “Bedri Krasniqi”, “Avni Feka”, “Sahit Krasniqi”, “Remzi Aliu”, “Fatmir Krasniqi”, “17 Shkurti”, “Behxhet Aliu”, “Martirët e Zogajve”, “Muharrem Parduzi”, “Bekim Berisha Abeja”, “Shala”, “Rexhë e Fadil Selmani”, “Ragip Musliu”, “Rasim Istrefi”, “Qazim Jashari”, “Xajë Jashari”, “Shefqet e Behxhet Cimili”, “Lutfi Musiqi”, “Lah Izmaku”, “Fexhrije Veseli Gërxhaliu”, “Sami Lahu”, “Shefki Grabanica”, “Zenun Gjocaj”, “Hajzer

Neziri”, “Rifat Banjska”, “Muhamed Rashica”, “Sadri Klinaku”, “Sherif Galica”, “Bajram Gashi”, “Vëllezërit Muzaqi”, “Fehmi Tërrnava”, “Nazif Ismajli”, “Xhemajl Hyseni”, “Shkodra”, “Abaz Jashari”, segmenti i rrugës “Rahman Krasniqi”, rruga “Hajrë Hajra”, “Tivari”, “Fetah Hyseni”, “Hoxhë Beqir Rashica”, “Naip Rashica”, “Rizah Rashica”, “Avni e Bedri Rashica”, “Naman e Zylfije Konoviku”, “Zylfije Krasniqi”, “Avdyl Mehmeti”, “Aziz Halili”, “Musli e Selim Drevinja”, “Basri e Ali Hyseni”, “Hasan Rashica”, “Igballe Prishtina”, “Istref e Rexhep Haziri”, “Fadil Beqiri”, “Adnan Bunjaku”, “Osman e Shaban Bunjaku”, “Faik Konica”, “Enver e Zymer Prronaj”, “Deli e Ali Rashica”, “Musli Gërguri”, “Hysen e Xhevdet Hyseni”, “Vëllezërit Zeqiri”, “Zeqir Rashica”, “2 Maji”, “Idriz Kurti”, “Halim Behrami”, “Hazir Muli”, “Hashim Kolla”, “Hazir Gërguri”, “Kadri Bajra”, “Fatmir Ejup Gërxhaliu”, “Qazim Ferati” dhe “Xhemajl Gërxhaliu”.


**8. \*Lagjja Iliria\*** kufizohet me segmentin e rrugës: “Bahri Kuqi” dhe “Mbretëresha Teutë”, rrugën “Ana Lin”, kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë: “Driton Merovci”, “Selim Muzaqi”, “Gjergj Fisha”, “Selman Miftari”, “Arsim Tahiri”, “Ferat Hasani”, “Sadri Jetullahu”, “Brukseli”, “Beshir Krasniqi”, “Fitim Dibrani”, “Sadik Idrizi”, “Sinan Haziri”, “Lutfi Islami”, “Abedin Ferizi”, “Trepça”, “Idriz Hasani”, “Mustafë Çuka”, “Nysret Zymberi”, segmenti i rrugës “Boletini”, rruga “Azem Bejta”, “Shotë Galica”, “Adem Demiraj”, “Sefedin Morina”, “Jonuz Jashari”, “Sabri Behrami”, “Imer Sheshivari”, “Demir Halili”, “Naim Zahiti”, “Muhamet Idrizi”, “Ejup Munishi”, “Nazmi Hyseni Popova”, “Hajriz Halili”, “Milaim Salihu”, “Mursel Krasniqi”, “Veli Xhafa”, “Mehmet Pashë Zogu”, “Ilaz Kodra”, “Isë Mërnica”, “Shefqet Karakashi”, “Halit Merovci”, “Hilmi Rrustemi”, “Selim Mërnica”, “Jakup Saraçi”, “Shaip Azemi”, “Ramë e Imrane Blakaj”, “Bajram Aliu”, “Rifat Krasniqi”, “Ahmet Hajra”, “Beqir Hyseni”, “Mirusha”, “Nezir Imeri”, “Haxhi Ibrahim”, “Ismail Galica”, “Selim Ferati” dhe segmenti i rrugës “Sekine Maxhuni”.

**9.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Administratës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**10.** Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7 ) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
Kryesuese e Kuvendit





## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/I-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.95/22, për trajtimin e kësaj çështjeje në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022**, merr këtë:

### VENDIM

#### PËR SHPËRNDARJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË TEJKALUARA PËR BUXHETIN E VITIT 2021

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në kategoritë ekomomike të cekura si më poshtë:

1.1 Mallra dhe shërbime .....	306,354.13 €
1.2 Shpenzime komunale.....	9,994.73 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	593,966.26 €
1.4 Investime kapitale.....	227,973.92 €

**Totali i mjeteve të tejkaluara.....1,138,289.04 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4.Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.95/22 i datës 28.4.2022.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**



## Bartja e mjeteve të tejkaluara gjatë vitit 2021

### Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	BARTJA 2022
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	59,697.62
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	246,656.51
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>306,354.13</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	9,994.73
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>9,994.73</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	74,912.36
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	190,000.00
Bujësi	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	192,670.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	8,514.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	77,400.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	8,999.90
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	41,470.00
<b>Subvencione</b>							<b>593,966.26</b>
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	IRI	Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF	85,940.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	IRI	Ndërtimi i shkollës në Gllavatn	147,000.00
<b>Kapitale</b>							<b>227,973.92</b>
<b>TOTALI</b>							<b>1,138,289.04</b>



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 153/2022

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 30.06.2022

VUŠTRRI - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligji Nr. 08/1-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.96/22, për trajtimin e kësaj çështjeje në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022**, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2021 NË VITIN 2022**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime .....	675,131.31 €
1.2 Shpenzime komunale.....	14,504.93 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	693,700.00 €
1.4 Investime kapitale.....	1,190,675.47€

**Totali i mjeteve të bartura.....2,574,011.71 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.96/22 i datës 28.4.2022.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**

## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

### Komuna: Komuna e Vushtrrisë

Programi	Kodi i nën-programit	Kodi FunkSIONAL	Fondi Burimor	Kategori a ekonomike	Kodi I projektit	Projektet	BARTJA 2022
Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	43890	Inventar për objektin e ri të komunës	4,200.00
Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	I Ri	Ndërtimi i sallës në objektin e komunës	121,000.00
Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	49479	Ndërtimi i deposë	30,000.00
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	41407	Ndërtimi i trotuareve	2,500.00
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	43900	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	21,194.80
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	46628	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	21,205.81
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	47962	Rregullimi i varrezave të martirëve	5,192.00
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	51202	Rindërtimi i rrugëve me infrastrukturë	1,125.82
Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	51826	Blerja e veturave për administratën komunale – Vushtri	10,000.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	18428	0320	22	30	I RI	Renovimi i objektit të zjarrfikësve	5,000.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	49561	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	87,081.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	51203	Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lumadh dhe Dumnicë e	5,439.65
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	51204	Rr. i shr.të lume, në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë të Mes	8,085.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	90231	Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave	16,360.58
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	41424	Ndërt.rrug lokale në fshatra	161,998.30
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	45265	Asfaltimi i rrugëve në qytet	43,525.58
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	I RI	Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc	100,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	49579	Rregullimi i hapësirave publike – shesheve	5,552.57
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	49588	Mbjellja e drunjve dekorativ	13,044.33
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	I RI	Rregullimi i hapësirave të rëntgenit - QKMF "Dr Safet Idrizi"	50,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	41427	Ndërtimi i QKMF në Vushtri	2,827.59
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	I RI	Ndërtimi i deposë për mbeturina medicinale	2,060.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	I RI	Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF	85,940.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	50059	Automjetet i terrenit për shëndetësi	30,000.00
Shërbimet sociale	75616	1040	22	30	49628	Renovimi i qendrës për kujdes ditor për të moshuar	20,000.00
Shërbimet Rezidenciale	75617	1060	22	30	50984	Renovimi i qendrës rezidenciale	3,800.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30	46840	Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi"	50,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30	48361	Ndërtimi i fushës ndihmëse te stadiumi i futbollit	10,510.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	I RI	Ndërtimi i shkollës në Gllavatin	147,000.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	41440	Ndërtimi i rrethojave në shkolla	2,878.14
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	46587	Fusha sportive	11,949.40
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	90282	Meremetimi i shkollave	5,541.94
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51008	Ndërtimi i toaleteve në shkolla	2,229.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	47970	Salla sportive	22,280.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	47909	Ndërtimi i çerdhes së re	39,557.60
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51868	Meremetimi i SHF. "Ali Kelmendi" –Sudime	10,000.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51873	Meremetimi i SHFMU "Azem Bejta" - Beçiq	4,000.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51858	Depo për shf. "Naim Frashëri"	7,796.36
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51859	Depo për shf. „Latif Berisha"	1,400.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51860	Depo për shf. „Mustafë Shyti"	1,400.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51865	Meremetimi i shfmu. "Lumni Surdulli"	6,000.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51872	Meremetimi i shf "Naim Frashëri" dhe ndërtimi i toaleteve	11,000.00
<b>TOTAL KAPITALE</b>							<b>1,190,675.47</b>



## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

### Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi FunkSIONAL	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	BARTJA 2022
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	14,000.00
Administrata -Vushtrri	16324	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	37,000.00
Inspeksioni	16647	0411	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Prokurimi	16820	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	3,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	2,700.00
Buxhetimi	17524	0112	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Zjarrefiksant dhe inspektimet	18428	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	14,350.00
Menaxhimi I fatkeqsive natyrore	18468	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	19,000.00
Zyra lokale e Komuniteteve	19620	1090	22	13		Mallra dhe shërbime	4,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	13		Mallra dhe shërbime	17,000.00
Shërbimet kadastrale	65120	0610	22	13		Mallra dhe shërbime	8,000.00
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtrri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	94,000.00
Administrata shëndetësi	73033	0760	22	13		Mallra dhe shërbime	1,729.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	13		Mallra dhe shërbime	74,250.00
Shërbimet sociale	75616	1040	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Shërbimet Kulturore	85024	0820	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	248,016.00
Arsimi parafillor - Qerdhja	92670	0911	22	13		Mallra dhe shërbime	75,418.01
Arsimi I Mesëm	94890	0922	22	13		Mallra dhe shërbime	22,668.30
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>675,131.31</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	10,000.00
Administrata	92120	0980	22	14		Shpenzimet komunale	4,504.93
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>14,504.93</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	125,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	190,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	230,000.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	78,700.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	50,000.00
<b>Subvencione</b>							<b>693,700.00</b>
<b>Kapitale</b>							<b>1,190,675.47</b>
<b>TOTALI</b>							<b>2,574,011.71</b>



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRA

01 Nr. / Br 154/2022

Nr. i sq. / Br. st -1-

Data / Datum 30.06.2022

VUSHTRRI - VUÇITRA



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja "d" lidhur me nenin 17 shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040/2008, nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenin 41.2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **30 qershor 2022**, merr këtë:


**V E N D I M**  
**PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSËS PËR SHFRYTËZIMIN E**  
**HAPËSIRAVE PUBLIKE**

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit, nga data 3.1.2022 deri më datën 28.12.2022.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Inspektime.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), në lidhje me nenin 14, paragrafi 1 dhe 17, shkronja (c) dhe (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 41, paragrafi 2, shkronja (ç) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **30 qershor 2022**, merr këtë:

### V E N D I M

**për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri**

1. Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Kuvendit të komunës me Nr. të protokollit Nr.100/22 i datës 28.4.2022 sipas vlerësimeve ligjore të dhëna nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me certifikatën e pronësisë në të cilën figuron që lloji i shfrytëzimit është Tokë Ndërtimore Shtëpi-Ndërtesë, ndërsa tani shfrytëzimi i këtyre parcelave është tokë ndërtimore. Parcela kadastrale P-70202016-00505-0 është bërë ndarja fizike dhe tani figuron si parcelë kadastrale P-70202016-00505-1, si dhe pjesë nga parcela P-70202016-00504-0. Lokacioni i ndërtimit dhe sipërfaqja e përgjithshme mbetet e njëjtë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi: obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**



# Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

18/1967

## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

**NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-00504-0**


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 18-1966-2022  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 29.06.2022 - 15:46  
Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtri / Vushtri / Vushtri  
Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202016-00504-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		6465			

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH/MARSHALA TITA				



## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		6465

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosni adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasništvo (1 VI.) / Single Owner	<b>Komuna e Vushtrrisë</b>	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtrri

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70202016-00504-0	Parcelë / Parcela / Parcel	6465
P-70202016-00505-1	Parcelë / Parcela / Parcel	720



Shkalla/Razmera/Scale: 1:855

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 29.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 03:44:39

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovdi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-00505-1


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 18-1966-2022  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 29.06.2022 - 15:45  
Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushitri / Vushitri / Vushitri  
Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202016-00505-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	720		29.06.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH/MARSHALA TITA			29.06.2022	



Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Printuar nga / Odstampani od / Printed by: Valon Maxhuni | P-70202016-00505-1

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/BackYard		720

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosni adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasnistvo (1 V1) / Single Owner	<b>Komuna e Vushtrrisë</b>	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		29.06.2022







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY



18/1967

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Vushtrri


Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 504=0, 505-1

Zona kadastrale / Katastarska zona: Vushtrri


Numri i lëndës / Broj predmeta: 100/22

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

KOPJE PLANI - KOPJA PLANA - COPY OF PLAN



Data. 29.06.2022



*[Handwritten signature]*

# Lokacioni i tregut (propozim)



- ZONE BANIMI
- SHKOLLA
- PARKU
- SHESHI
- LUMI TERSTENA
- STADIUMI
- TREGU i propozuar (Strukturë hapësinore)
- MUNDESI ZGJERIMI ( me kthesa në 16 ardhmen)



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

№ i Protokollit: 06  
№ i Protokollit: 2802-2/22  
Data: 02.06.22  
PRISHTINË / A

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING  
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data: 06.06.2022  
Data:

Niveli i Organizatës	nr. i kështjës	Vleta
-81-	020-413/21	

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrri, Melihate Basholli - Latifi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor Data: 31.05.2022
Zyrtarët përgjegjës:	
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Prishtinës
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.100/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbërt për prodhime vendore në Vushtri, miratuar nga KK Vushtri

I nderuari Kryetar, Idrizi,  
E nderuara Kryesuese, Basholli-Latifi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 17.05.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.100/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbërt për prodhime vendore në Vushtri, miratuar nga KK Vushtri.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Vushtrri:

### **Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit**

Vendimi Nr.100/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbërt për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri.

### **A r s y e t i m i**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.100/22 për caktimin e lokacionit për ndërtim të tregut të gjelbërt për prodhime vendore në Vushtrri, miratuar nga KK Vushtrri, konstatoi se:

Vendimi edhe pse është i bazuar në dokumentin e planifikimit hapësinor gjegjësisht Planin Zhvillimor Komunal i Vushtrrisë 2016-2024, shkresave të lëndës gjegjësisht Vendimit Nr.100/22 i është bashkangjitur edhe Certifikata dhe kopja e planit të Njësisë Kadastrale P-70202016-00504-0, 00505-0, 00520-0, në të cilën është caktuar lokacioni për ndërtim të tregut të gjelbërt, ndërsa, në njësitë kadastrale 00505-0, 00520-0 figuron që lloji i shfrytëzimit është Tokë Ndërtimore Shtëpi-Ndërtesë.

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të mirret vendim i drejtë dhe i ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.